



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Seanca plenare e Kuvendit

P- 003

Prishtinë, më 15 dhjetor 2014

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 DHJETOR 2014**

Seancën e kryesoi **Kadri Veseli**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e seancës plenare, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit. Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 95 deputetë.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetaret e grupeve parlamentare, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryetari tha se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar për miratim emërtimin, numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Kryetari e hapi debatin lidhur me pikën e lartpërmendur.

Në vazhdim për fjalë u paraqitën deputetët: Adem Grabovci, në emër të GP PDK; Ismet Beqiri, në emër të GP LDK; Visar Ymeri, në emër të GP VV; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP AAK; Valdete Bajrami, emër të GP NISMA; Duda Balje, në emër të GP “6+”, si dhe Danush Ademi, Arben Gashi, Bekim Bislimi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Ismajl Kurteshi, Alma Lama, Pal Lekaj, Emilija Rexhepi, Vjosa Osmani, Sabri Hamiti dhe Kujtim Paçaku, fjala e të cilëve është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari më pas dha disa sqarime juridike lidhur me procesin vendimmarrës për këtë çështje. Fjala e kryetarit është dhënë e plotë në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozim-vendimin për emërtimin, numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 58,
Kundër ----- 32,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozim-vendimin për emërtimin, numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Ai tha se miratimi i këtij propozim-vendimi kërkon 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

* * *

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 11:12 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri Veseli

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*